

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

Carlo Ballio: Pasi po certifikohet rezultati nga rinumërimi tek Pallati Sportiv, besueshmëria e Sali Berishës u zgjerfaq nën "trenin bullgar"

2

Spartak Ngjela: Çfarë do të bëjë Berisha dhe PD, pasi të mbarojë rinumërimi?

3

Sulmet Izrael- Iran/ Putin: Teherani ka të drejtë për energji bërthamore civile! Dëshkon takimi sekret midis ShBA-së dhe Iranit në Stamboll

4

Shëngjin/ Rana e Hedhur: Tërheq turistët e huaj me kampëra: Pene e bregdetit shqiptar, ia vlen të vizitohet

5

Ortën Hila: Një keshillë për ndjekësit e Berishës!

Kronikë

3 vëllezërit kërcënojnë me armë të riun në Tiranë, 2 në pranga, njëri në kërkim

Policia e Tiranës ka vënë në pranga dy vëllezër dhe kanë shpallur në kërkim të tretin, pasi dyshohen se kanë kanosur me armë zjarri një 30-vjeçar.



Redaksia
21 Qershor, 13:03 | Përditësimi: 21 Qershor, 13:10

Tre vëllezër kërcënuan me armë një 30-vjeçar në rrugën “Tafaj” në Tiranë. E njoftuar për ngjarjen, policia arrestoi 2 nga vëllezërit, Alfred dhe Resmi Meta 41 dhe 46 vjeç dhe shpalli në kërkim të tretin, [Gentian Meta](#) 45 vjeç.

Sipas një njoftimi zyrtar të policisë, ata e kanosën të riun për motive të dobëta, por blutë nuk japim më shumë detaje.

Në banesat e dy vëllezërve të arrestuar në Tufinë, shërbimet e policisë gjetën dhe sekuestruan 3 pistoleta municion luftarak. Efektivët sekuestruan edhe 1 makinë.

"Kanosën me armë zjarri një 30-vjeçar, pasi u konfliktuan për motive të dobëta, në rrugë, identifikohen 3 shtetas (vëllezër). Vihen në pranga 2 prej tyre, punohet për kapjen e tjetrit. Sekuestrohen 3 armë zjarri pistoleta, municion luftarak dhe 1 automjet. Specialistët e Komisarariatit të Policisë Nr. 4, në bashkëpunim me shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiptarja”, pas marrjes së njoftimit se në rrugën “Tafaj”, një 30-vjeçar ishte kanosur me armë zjarri nga 3 shtetas, organizuan dhe finalizuan operacionin policor “Triangle”, për identifikimin dhe kapjen e tyre.

Në kuadër të operacionit u arrestuan shtetasit: A. M., 41 vjeç dhe R. M., 46 vjeç, dhe u shpall në kërkim shtetasi G. M., 45 vjeç (vëllezër).

Nga hetimet dyshohet se këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, pas një konflikti për motive të dobëta, me një 30-vjeçar, e kanë kanosur atë me armë zjarri. Në vijim të veprimeve, gjatë kontrollit në banesat e dy shtetasve të arrestuar, në Tufinë, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan 3 armë zjarri pistoleta dhe municion luftarak”, njoftoi Policia e Tiranës.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Sl.E./r.k./Shqiptarja.com

TAG: [Gentian Meta](#) [Resmi Meta](#) [Alfred Meta](#) [policia e tiranes](#) [Tirane](#)

Komento

Komente

© Ndalohe

Sondazhi i ditës:
Çmimet më të larta se në BE, a mendoni se duhet të ndërhyjë qeveria?

20 Qershor, 11:01

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

21 Qershor, 15:04

21 Qershor, 14:34

21 Qershor, 14:05

21 Qershor, 13:12

21 Qershor, 11:55

21 Qershor, 10:18

21 Qershor, 09:40

21 Qershor, 07:53

20 Qershor, 18:08

20 Qershor, 17:16

20 Qershor, 13:31

20 Qershor, 12:06